



## REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA –REPUBLIC OF KOSOVO

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

**Në çështjen juridike të:**

**AC-I- 14-0092**

***Paditësit/Ankuesi***

**Ž. dhe M. M**

Përfaqësuar nga D. L, a.nga Fushë Kosova

**Kundër:**

***Të paditurat***

**1. NSH, K. B I, K E -Fushë Kosovë**

**2. Agjencia Kosovare e Privatizimit ,rr. Agim Ramadani” 23, Prishtinë**

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Ilmi Bajrami gjyqtar kryesues, Sabri Halili dhe Mr. Sc. Sahit Sylejmani gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e ankuesve, të parashtruar kundër Aktvendimit të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së, SCC-08-0126 të datës 13 shkurt 2014, në seancën vendimmarrëse të mbajtur më 12 mars 2020, lëshon këtë:

### **A K T V E N D I M**

- 1. Ankesa e paditësve është e bazuar.**
- 2. Anulohet Aktvendimi i Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së, SCC-08-0126 i datës 13 shkurt 2014.**
- 3. Lënda kthehet në shkallë të parë të DHPGJS-së për gjykim.**

## **Rrethanat Faktike dhe Procedurale**

Më 8 maj 2008, Paditësi ushtroi padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (Dhoma e Posaçme) për ti vërtetuar ata ti bashkëpronarë të ngastrës kadastrale Nr 569/1 që ndodhet në P.. në vendin e quajtur "P..", prej 0,97,00 ha, e regjistruar si ngastra Nr 125 në zonën kadastrale Preoc. Paditësit kërkuan nga Dhoma e Posaçme që të aprovojë Vendimin 06 br. 462-112/91 të Komisionit për Kthim të Tokave në Prishtinë, si dhe t’jua lejojë regjistrimin në evidencat kadastrale. Ata kërkuan edhe pagesën të shpenzimeve procedurale.

Paditësit pohuan se tokën e lartpërmendur ia kishte konfiskuar babait të tyre të ndjerë Komisioni i Qarkut për Fondin e Tokës Bujqësore për Qarkun e Graçanicës më 19 gusht 1953. Supozohet se toka më vonë i është ndarë NSH-së K... Pretendohet se Paditësit janë deklaruar trashëgimtarë të babait të tyre të ndjerë nga Gjykata Komunale e Prishtinës më 4 qershor 1990. Komisionit për Kthim të Tokave në Prishtinë me Vendimin e tij 06 Br. 462-112/91 i vërtetoi Paditësit si bashkëpronarë të ngastrës kadastrale nr 569/1 në Preoc. Vendimi hyri në fuqi më 30 prill 1996.

Më 31 korrik 2008 u pezulluan procedurat në pajtim me Vendimin Ekzekutiv të UNMIK-ut 2008/34 të datës 29 korrik 2008. Pezullimi u hoq më 16 korrik 2009, në të njëjtën kohë të Paditurve ju dërgua padia.

AKM-ja ushtroi mbrojtjen e saj më 26 gusht 2009. NSH-ja nuk ushtroi mbrojtje. AKM-ja kërkoi nga Dhoma e Posaçme që të refuzojë padinë si të pabazuar, duke pohuar se Paditësit nuk kishin dëshmuar se në fakt ata ishin trashëgimtarët e pronarit të mëparshëm të pronës. Ajo më tutje argumentoi se Paditësit nuk kishin dorëzuar ndonjë dëshmi që do të tregonte se babai i tyre ishte i regjistruar si pronar i pronës. Më në fund, ajo pohoi se Paditësit nuk kërkuan përmbarimin e Vendimit të lartpërmendur për kthimin e tokës në pajtim me Nenin 379 (1) të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve të RFJ-së brenda afatit ose nuk treguan se nuk janë në gjendje të bëjnë një gjë të tillë.

Paditësit ushtruan përgjigjen e tyre më 16 tetor 2009. Ata pohuan se kanë marrë tokën në posedim menjëherë pasi vendim për kthim të tokës u bë i formës së prerë,

por ata nuk ishin në gjendje ta regjistrojnë pronësinë e tyre në zyrën kadastrale pa pëlqimin e AKM-së. Paditësit pohuan më tutje se neni 379 i Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve nuk zbatohet në këtë rast për arsye se e drejta për të kërkuar të drejtat e pronësisë nuk mund të parashkruhej.

Përgjigja iu dërgua të Paditurve më 17 dhe 18 dhjetor 2009. Të Paditurit nuk ushtruan kundërpërgjigje brenda afatit të dhënë; andaj procedurat me shkrim janë mbyllur në pajtim me nenin 32 (c) të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2008/6.

Më 12 janar 2010 Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) ushtroi kërkesë pranë Dhomës së Posaçme që të pezullohet procedura për shkak të Likuidimit të NSH-së. AKP-ja e dorëzoi ekstraktin e procesverbalit të takimit të Bordit të Drejtorëve të AKM-së të datës 5 prill 2007, propozimin e likuidimit të "L..." të datës 22 shkurt 2007, letrën që njoftonte Dhomën e Posaçme për likuidimin e Lavërtaria Blegtoria.

Më 13 mars 2014 Kolegji i Specializuar me Aktvendim SCC-08-0126 pezullon procedurën për shkak se me Vendimin e Bordit të AKP-së në këtë Ndërmarrje ka filluar procedura e Likuidimit.

Më 24 mars 2014 paditësi ka parashtruar ankesë ( më tutje ankuesi) kundër Aktvendimit SCC-08-0126 të datës 13 mars 2014 ( me tutje Aktvendimi i ankimuar) me të cilën kërkoi prishjen e Aktvendimit të ankimuar dhe vazhdimin e procedurës se pezulluar.

AKP-ja në përgjigjen e vetë të datës 10 prill 2018 kundër Aktvendimit te cekur me larte për pezullim, kërkoi nga Kolegji i Apelit refuzimin e ankese dhe vërtetimin e Aktvendimit të ankimuar.

### **Arsyet ligjore**

Ankesa është e pranueshme, dhe e bazuar. Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit Nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet lidhur me Agjencinë e Privatizimit, Kolegji i Apelit vendosi që të mos e mbajë pjesën gojore të procedurës.

Agjencia Kosovare e Privatizimit ka njoftuar Dhomën e Posaçme se me Vendimin e Bordit të datës 5 prill 2007, ndaj NSH "L.." ka filluar procedura e likuidimit që nga data 22 shkurt 2007.

Padia në këtë lëndë është parashtruar pas fillimit të procedurës së likuidimit të paditurës nga AKM-ja.

Sipas nenit 10.1 të Shtojcës së Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Ligji nr. 04/L-034) (më tutje: SHTOJCA e LAKP-së), çdo veprim gjyqësor, administrativ apo i arbitrazhit, procedurë apo akt që përfshin apo që është kundër një ndërmarrje (apo asetëve të saj) që është subjekt i Vendimit për Likuidim pezullohet pas parashtrimit të njoftimit të Vendimit për Likuidim nga ana e Autoritetit të Likuidimit në gjykatën përkatëse, autoritetin publik apo tribunalin e arbitrazhit. Prandaj, si parim i përgjithshëm likuidimi vullnetar i një ndërmarrje e parandalon vazhdimin e procedurave gjyqësore, pas parashtrimit të padisë me rastin e fillimit të procedurës së likuidimit. Padia e rregullt kreditore e parashtruar pas fillimit të likuidimit kundër ndërmarrjes në likuidim- në parim- duhet të hedhet poshtë si e papranueshme (ACS-09-0075).

Likuidimi duhet të sigurojë trajtim të barabartë (të ligjshëm) të kreditorëve, të cilën nuk do të jenë në gjendje më të ndjekin interesin e tyre individual pavarësisht kreditorëve tjerë, brenda procedurës së rregullt civile. Kushti për vetëm procedurë të likuidimit është që të ndalohen të gjitha veprimet, procedurat apo veprimet e çfarëdo lloji me qëllim të zbatimit apo përmbushjes së padive individuale kreditore, dhe të shqyrtohen të gjitha dhe të përmbushen sipas përcaktimit në Shtojcën e ligjit të AKP-së.

Megjithatë, kjo është një padi pronësore e parashtruar pas fillimit të procedurës së Likuidimit, ankuesit pohojnë se posedojnë vendimin mi kthimin e pronës së kontestuar.

Esenca e padisë është e ndryshme nga padia e zakonshme kreditore. Kolegji i Ankesave shton se pezullimi i procedurës nuk mund të pranohet për shkak të faktit se kjo çështje objekt kontesti ka pronën. Është pohuar nga Kolegji i Ankesave në praktikën e saj të vazhdueshme (shih p.sh. ASC- 10-0021, ASC- 11-0004) se në qoftë se pezullimi i çështjes vonon qartësimin e statusit ligjor të një prone pronësia e së cilës është kontestuar ose do të rezultojë në një ndryshim të statusit, kjo nuk do

të përputhet me parimet themelore të procedurave të likuidimit, njohjen e te drejtës së një personi në pronësi.

Për të sqaruar këtë çështje, është e nevojshme që të identifikohet mbrojtja ligjore e paditësve të cilët i kërkojnë të drejtat pronësore kundër NSH-së në likuidim.

Përfundimisht, interpretimi i nenit 9.3 i RREG të UNMIK-ut 2002/12 i dhënë në mënyrë implicite nga Kolegji i Specializuar nuk është në përputhje me mbrojtjen e të drejtave pronësore sipas nenit 1 të protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, pasi që do të privonte paditësin nga e drejta e tij që t'i mbrohet e drejtat e tij pronësore nga një gjykatë e pavarur (cf. SCC-06-0010). Për këtë arsye, Aktvendimi i kolegjit të Specializuar për pezullimin e procedurës duhet të anulohet dhe padia duhet të kthehet për gjykim në Kolegjin e Specializuar.

Mbi bazën e këtyre arsyeve e në bazë të nenit 10.10 të LDHP-së është vendosur si në dispozitiv.

### **Taksat gjyqësore**

Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën pasi që lista e taksave gjyqësore që ka hyrë në fuqi për DHPGJS-në më 27 mars 2014 nuk mund të aplikohet për rastet në pritje në mënyrë retrospektive

Lëshuar nga kolegji i Apelit i DHPGJS, më 12 mars 2020.

Ilmi Bajrami, Gjyqtar Kryesues

\_\_\_\_\_

